



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Autoriteti Kosovar i Konkurrencës
Autoritet Kosova za Konkurenciju - Kosovo Competition Authority

PËR/ZA/TO:	Z. Ilir RAMA – Drejtor, Ministria e Financave - Departamenti Qendror për Partneritet Publiko Privat				
NGA:	Valon PRESTRESHI – Kryetar Ahmet KRASNIQI – zv. Kryetar Fatime Haziri - Anëtare Muhamet KRASNIQI – Anëtar Shaqir MORINA - Anëtar Komisioni i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës				
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Mendim profesional për DQPPP-MF, mbi: <i>Programin Nxitës 2016 – 2018 për Produktin e ri, Stimulimi për shërbimet e trajtimit të kufizuar tokësor (Limited Ground Handling Service Incentive)</i>				
Nr. i zyrës:		Lokacioni:		Data:	
Br. kancelarije:	211	Kucni:	Prishtinë	Datum:	30.12.2016
Room No.:		Extension:		Date:	

I nderuari z. Rama,

Bazuar në shkresën tuaj të datës 09.11.2016 me të cilën keni kërkuar dhënien e një mendimi profesional nga AKK-ja, lidhur me *Programin Nxitës 2016-2018 të Produktit të ri*, i propozuar nga zyrtarët e LIMAK/ANP për DQPPP, përkitazi mbi këtë propozim më poshtë japim opinionin tonë.

- Produkti i ri i propozuar që është stimulimi për shërbimet e trajtimit të kufizuar tokësor (*Limited Ground Handling Service Incentive*), i cili ofron ulje në pakon GH (ground handling) 50 % të pagesave të trajtimit në terren për linjat ajrore që nuk transportojnë mallra të tokës, i është drejtuar linjave ajrore që transportojnë vetëm udhëtarët dhe bagazhet e tyre (aty ku nuk ka lloj përzjerje e trafikut). Qëllimi i këtij produkti të ri është që të stimulojë shërbime e reja ajrore të ofruara nga/në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës (ANP) nëpërmjet reduktimit të shërbimeve të trajtimit të ngarkesave (Cargo). Produkti do të jetë i zbatueshëm për linjat ajrore të cilat i përmbushin kushtet dhe kriteret e caktuara nga koncesionari në bashkëpunim me DQPPP-në.

Baza Ligjore

Ne mbështetje të Ligjit Nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës, të nenit 23 dhe 28 paragrafi 1.11, Komisioni i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës, jep mendimin profesional për çështjen e parashtruar nga DQPPP, si më poshtë:

Opinion

Me fillimin e programit të stimulimit, propozuesi i këtij programi pretendon se objekti i saj qëndron në ofrimin e një produkti të ri – nxitës, shfrytëzimin e burimeve në mënyrë racionale dhe nxitje për linja të reja, me qëllim që LIMAK/ANP të jetë konkurrues me aeroportet e rajonit. Autoriteti sugjeron se çdo kufizim ligjor apo faktik i numrit të operatorëve të cilët janë potencial për tu angazhuar në një veprimtari në një treg të caktuar (*numerus clausus*) në përgjithësi është e kundërligjeshme nga pikëpamja e konkurrencës, që konkurrentët/operatorët të mos kufizohen nëpërmjet kushteve dhe kriterëve, sepse për të pasur konkurrencë të mirëfilltë duhet që të ketë sa më shumë konkurrent në tregun relevant.

Në fund, përfitues nga kjo nxitje apo stimuli të jetë pasagjeri, të cilit duhet t'i jepet mundësia e zgjedhjes.

Konkurrenca e mundshme (potential competition) përfshin mundësin e hyrjes në treg të konkurrentëve të rinj. Hyrjet e reja mund të vijnë nga konkurrentët që veprojnë në një treg gjeografik tjetër (për shembull, të huaja). Ndërmarrjet e tjera mund të hyjnë në treg nëse evitohen pengesat në hyrje ose ato janë të pranueshme dhe konkurruese. Pengesat mund të jenë ligjore ose mund të jenë kontraktuale (për shembull, kushtet kufizuese).

Autoriteti ka shqyrtuar dokumentacionin në dispozicion, kushtet dhe kriteret e stimulit dhe nxitjes së operatorëve në tregun përkatës si dhe sqarimet në takime nga të gjithë akterët relevant siç janë: DQPPP, AAC dhe LIMAK/ANP.

KONSTATOJMË se pas vlerësimit të dokumentacionit të ofruar në lidhje me produktin e ri nxitës, tek kriteret e caktuara për përfitimin e këtij produkti, vërejmë se tek pika (a), (b) dhe (c) mund të paraqiten pengesa të cilat e vështirësojnë qasjen e operatorëve potencial në tregun relevant, e të cilat mund të bien ndesh me Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës neni 11 – Abuzimi me pozitën dominuese ndërsa sa i përket kriterëve tjera nëpër pika të caktuara në dokument, Autoriteti vëren se nuk bien ndesh me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës.

Njëherit Autoriteti Kosovar i Konkurrencës ka për detyrë ta monitorijë Aeroportin e Prishtinës si ndërmarrje në Pozitë Dominuese sa herë që ngritet dyshime në ç'rregullimin e konkurrencës.

Cdo ndryshim tjetër që mund të ndodh nga “*stimulimi për shërbimet e trajtimit të kufizuar tokësor (Limited ground handling services incentive)*”, të njoftohet Autoriteti Kosovar i Konkurrencës në të kundërtën shkelja e këtyre dispozitave ka si pasojë shqiptimin e masave ndëshkuese administrative sipas Ligjit Nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës neni 56.

Produkti i ri nxitës duhet të jetë i limituar në kohë dhe është e preferueshme të jetë koherent me Programin Nxitës 2016-2018 të miratuar nga AAC-ja.

SUGJEROJMË që lista e çmimeve të shërbimeve të trajtimit në tokë (groundhandling) që LIMAK/ANP ka në fuqi aktualisht dhe që ju ofrohet kompanive ajrore si pako, të zbërthehet në listë shërbimesh me çmime sipas të cilës operatorët do të kenë mundësi të paguajnë vetëm për shërbimet të cilat i pranojnë. Si e tille ekzistimi i një liste, do të evitonte nevojën për të dhënë nxitje si kjo e cila u trajtua më lartë.

Me respekt,